

I.I.S. CATTANEO - DELEDDA



OLLA E LARTE: INSTRUZIONE PERDORIMI

www.cattaneodeledda.it
segreteria@istitutosuperiorecattaneo.191.it

FONDAZIONE CEIS – Ufficio Prevenzione tel 059315331 prevenzione@gruppoceis.org

- **Si dhe kur bëhet regjistrimi për vitin e parë të shkollës së lartë?**

Zakonisht brenda muajit Janar, paraqitet një kërkesë pranë sekretarisë së Shkollës së Mesme, që ndjek djali/vajza.

- **Si dhe kur bëhet regjistrimi për vitin pasardhës të vitit të parë të shkollës së lartë?**

Zakonisht brenda muajit Janar, paraqitet kërkesa pranë sekretarisë së Shkollës së Lartë, që ndjek djali/vajza. Çdo shkollë informon familjet për periudhën dhe mënyrën e regjistrimit.

- **Si është i ndërtuar sistemi arsimor italian?** (marrë nga “Mirësevini në shkollën italiane. Informacionet e para për mirëpritjen” nën kujdesin e provincës së Milanos. shih http://www.provincia.milano.it/export/sites/default/scuola/nonunodimeno/doc/benvenuto_nella_scuola_italiana_en.pdf)

Në Itali, çdo nxënës duhet të ndjekë shkollën ose formimin profesional deri në moshën 18 vjeç. Kjo e drejtë/detyrim u përket edhe të gjithë nxënësve të huaj, që jetojnë rregullisht ose jorregullisht në Itali, me apo pa lejeqëndrimi (permesso di soggiorno).																
Tipi i shkollës	Shkolla e fëmijërisë (kopshti)			Shkolla parësore (ish shkolla fillore)					Shkolla dytësore e nivelit të parë (ish shkolla e mesme e ulët)			Shkolla dytësore e nivelit të dytë (ish shkolla e mesme e lartë)				
Numri i viteve	1	2	3	1	2	3	4	5	1	2	3	1	2	3	4	5
Brezi i moshës	nga 3 vjeç			nga 6 vjeç					nga 11 vjeç			nga 14 vjeç				
* është e mundur të fillohet shkolla e fëmijërisë në moshën dy vjeç e gjysëm dhe shkolla parësore (fillore) në moshën pesë vjeç e gjysëm.																

- **Si bëhet vlerësimi i nxënësve të huaj?**

Nxënësit e huaj vlerësohen njëjloj si nxënësit italianë.

Për nxënësit e huaj të sapo emigruar, çdo shkollë mund të programojë një ecure të personalizuar, duke evidentuar lëndët për të cilat është e mundur të bëhet një vlerësim i menjëhershëm (psh. lëndët praktike, si edukimi fizik, edukimi muzikor, vizatimi, informatika, etj apo edhe anglishtja e frengjishtja - nëse bënin pjesë në programin mësimor të studimit në vendin e origjinës - dhe matematica).

Për lëndët e tjera, përmbajtja mund të jetë e thjeshtuar dhe e zgjedhur; për më tepër studimi i nxënësit në kurset e alfabetizimit apo të mbështetjes gjuhësore, si brenda shkollës, ashtu edhe pranë CTP-së, do të shërbejë për vlerësimin e gjuhës italiane ose edhe të lëndëve të tjera.

Vetëm në rastin kur nxënësit nuk kanë mësuar gjuhën italiane në nivel të mjaftueshëm për të mund të studiojnë disa përmbajtje, mund të mos bëhet vlerësimi, duke bërë shënimin N.C. (non classificabile/ i paklasifikueshëm) në skedën e vlerësimit, dhe duke shpjeguar arsyet.

- **Leximi i dëftesës: si bëhet vlerësimi i lëndëve të ndryshme dhe i sjelljes?**

Notat e vlerësimit janë nga 1 deri në 10.

Të gjitha notat nga 6-ta e më lartë tregojnë vlerësim pozitiv.

5,4,3,2,1 janë vlerësime negative.

Edhe në sjellje notat variojnë nga 1 deri në 10; nëse një nxënës vlerësohet me notën 5 në sjellje nuk kalon klasën. Çdo shkollë, nëpërmjet një tabele, që mund të kërkohet në sekretari, përshkruan sjelljet që korrespondojnë me çdo notë.

- **Cilat janë kërkesat që duhen përmbushur për të kaluar klasën?**

Për të kaluar klasën, në qershor duhet që nxënësi të ketë në të gjitha lëndët nota pozitive (6 ose nota më të larta).

- **Nëse notat nuk janë të gjitha pozitive çfarë ndodh?**

Nëse ka një ose më shumë nota negative (nota 5 ose nota më të ulta) Këshilli i Klasës (i përbërë nga të gjithë mësuesit e klasës) mund të vendosi që nxënësi :

- të mos kalojë klasën (kur ka disa pamjaftueshmëri dhe që janë shumë të rënda) ;
- ose të caktojë shlyerjet formuese.

- **Çfarë është një shlyerje formuese?**

Është një lëndë jo e studiuar si duhet, të cilën nxënësi duhet ta shlyej.

Kur nxënësi ka një ose më shumë shlyerje formuese, do të thotë se nuk ka mjaftueshmërinë e nevojshme në këto lëndë. Në lëndët që duhen shlyer notat janë 5 ose nota më të ulta.

Detyrë e nxënësit, në këtë rast, është studimi dhe dhënia e një provimi në Shtator, nëpërmjet të së cilit tregon se ka marrë dijet e mjaftueshme.

- **Si bëhet shyerja e mangësive në formim?**

Mësuesit mund të vendosin që nxënësi:

- të studiojë individualisht lëndët në të cilat ka mangësi dhe më pas të japi një provim për çdo lëndë për të cilën duhet të shlyejë mangësitë.
- të ndjekë një kurs për marrjen e dijeve dhe më pas të japi provimin për çdo lëndë, për të cilën ka mangësi.

Nëse nxënësi kalon provimet në Shtator, për çdo lëndë që i është dashur të shlyej mangësitë formuese, atëherë kalon vitin, nëse nuk arrin të vlerësohet pozitivisht në provim nuk kalon vitin.

- **Si funksionojnë kurset për marrjen e dijeve?**

Kurset për marrjen e dijeve nuk aktivizohen për çdo lëndë.

Nëse një nxënës që ka mangësi formuese dërgohet të ndjekë një kurs për marrjen e dijeve, familja mund të zgjedhi që:

- të mos ta dërgojë fëmijën në këtë kurs;
- ta dërgojë fëmijën në kurs.

Nëse familja zgjedh ndjekjen e kursit, ajo do të informohet nëpërmjet fëmijës, se kur dhe ku do të organizohet kursi.

- **Çfarë tregon numri i mungesave në lëndë të ndryshme?**

Numri i mungesave shënohet për orë dhe jo për ditë. Psh. nëse një ditë nxënësi mungon dhe ndërkohë në program ka dy orë gjuhë italiane, mësuesi shënon dy orë mungesë.

Për çdo vit shkollor parashikohen të paktën dyqind ditë shkollë. Ndjekja e orëve të mësimin nuk duhet të jetë më pak se 75% e totalit të orëve, përjashtuar arsyet e rëndësishme dhe të vërtetueshme.

- **Si funksionon takimi me mësuesit?**

Pak kohë pasi është caktuar orari përfundimtar, zakonisht në mesin e muajit tetor, çdo mësues informon për orarin javor të takimeve (një orë në javë).

Nxënësve u njoftohet me shkrim orari i takimeve i të gjithë mësuesëve të klasës.

Prindi mund të paraqitet në sallën e mësuesëve në oraret e përcaktuara për t'u takuar me mësuesit.

Në disa shkolla është i nevojshëm prenotimi i takimeve.

Ka disa periudha gjatë vitit, në të cilat takimet ndërpriten. Familjet njoftohen nëpërmjet fëmijëve, në fillim të çdo viti shkollor, për këto periudha ndërprerjeje.

- **Çfarë përmban rregullorja e shkollës?**

Rregullorja e shkollës normon jetën shkollore të nxënësve.

Në të përcaktohen rregullat në lidhje me:

- hyrjen e nxënësve;
- mënyrat dhe kohën për justifikimin e mungesave dhe të vonesave;

Çdo fillim viti nxënësve u lexohet dhe u shpjegohet rregullorja .

Nëse një nxënës nuk respekton rregulloren e shkollës, mësuesi bën një shënim në regjistrin e klasës.

Nëse një nxënës merr disa shënime ose kryen një shkelje të rëndë, Këshilli i klasës (të gjithë mësuesit e klasës) mund të vendosi që:

- t'i dërgojë familjes një letër paralajmërimi (qortimi);
- të pezullojë nxënësin për një periudhë që shkon nga 1 deri në 15 ditë.

- **Çfarë funksionesh kanë përfaqësuesit e klasës (të prindërve dhe të nxënësve)?**

Përfaqësuesi i prindërve të klasës

Përfaqësuesit e prindërve të klasës kanë për detyrë të bëhen zëdhënës, që parashetrojnë problemet, nismat, propozimet, nevojat e klasës, në Këshillin në të cilin bëjnë pjesë dhe, njëkohësisht, tek përfaqësuesit e Këshillit të Institutit.

Prindërit e nxënësve të çdo klase mund të zgjedhin dy prindër si përfaqësues të klasës.

Përfaqësuesi i nxënësve të klasës

Përfaqësuesit e nxënësve të klasës kanë për detyrë të bëhen zëdhënës të klasës; veprojnë dhe kanë si bashkëbisedues mësuesin/ët e tyre, si dhe shprehin mendimin e tyre në lidhje me problemet edukative dhe didaktike.

Nxënësit e çdo klase mund të zgjedhin dy nxënës si përfaqësues të klasës.

- **Si mund të njohin prindërit emrat e përfaqësuesve të klasës së fëmijës së tyre?**

Zakonisht, brenda muajit tetor, bëhet mbledhja e asamblesë së prindërve të çdo klase.

Të gjithë prindërit ftohen të marrin pjesë e të votojnë përfaqësuesit e tyre.

Nëse ndonjë prind nuk ka marrë pjesë në përzgjedhjen e përfaqësuesve, ai mund t'i drejtohet Sekretarisë didaktike dhe t'i kërkojë të njihet me emrat e prindërve të zgjedhur si përfaqësues.

- **Si organizohen ekskursionet dhe daljet?**

Daljet didaktike dhe ekskursionet përcaktohen dhe miratohen nga Këshilli i Klasës dhe nga Këshilli i Institutit. Që të mund të bëhet një ekskursion, duhet që në të të marrin pjesë të paktën 2/3 e nxënësve të klasës. Nxënësit gjatë ekskursioneve shoqërohen nga mësuesit e klasës. Përpara çdo ekskursioni nxënësi duhet të paguaj të gjitha shpenzimet e udhëtimit.